



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 36 /2020
Datë: 16 / 04 2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt.19.02.2020). Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin e Projekt - Udhëzimit Administrativ për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ardian Bajraktari, Departamenti Ligjor/MD, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues nga Kabineti i Ministrisë së Drejtësisë, Anëtar;
 - 1.3. Tre (3) përfaqësues nga Oda e Noterëve të Kosovës, Anëtarë;
 - 1.4. Përfaqësues nga Departamenti për Profesione të Lira/MD, Anëtare;
 - 1.5. Floriana Rugova, Departamenti Ligjor/MD, Anëtare;
 - 1.6. Florim Shefqeti, Oda e Avokatëve të Kosovës, Anëtar;
 - 1.7. Gent Salihu, Përfaqësues nga Programi për Drejtësi Komerciale i USAID-it, Anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues nga Zyra e BE-së, Anëtar;
 - 1.9. Përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës, Anëtar.
2. Sipas nevojave të Grupit Punues dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe anëtarë tjerë në grup punues.
3. Grupi punues nga pika një (1) e këtij vendimi obligohet të hartoj dhe finalizoj Projekt Udhëzimin Administrativ për shpërblimin për punë dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimet, siç parashihet me Ligjin Nr.06/L-010 për Noterinë, neni 16 paragrafi 1.
4. Gjatë hartimit të Projekt- Udhëzimit Administrativ sipas këtij vendimi, Grupi Punues duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe standardeve në fuqi për hartimin e legjislacionit.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU

Ministre në detyrë e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Kabinetit të Ministres;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.